



2301

131/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
SEKTORI I SEKRETARISË TEKNIKE

Nr. 1148/11 Prot.Tiranë, më 26.09.2023

Lënda: Kthim përgjigje.

QENDRËS "RES PUBLICA"

Blv. "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, dërguar me anë të postës elektronike më datë 21.09.2023, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me nr. 1148 Prot, datë 22.09.2023, në lidhje me ndërtimin e ujësjellësit Himarë, Ju informojmë si më poshtë vijon:

Bazuar në Ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulture dhe Muzetë", neni 38, pika 1 "Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore...", i cili në mbledhjen e datës 16.09.2022 ka miratuar projektin "Sistemi i Furnizimit me Ujë të Himarës, Lidhja e Linjës Kryesore të Dërgimit me sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave Pilur, Kudhës, Himar Fshat dhe Vuno si dhe Rrjeti i Brendshëm i Ujësjellësit të këtyre fshatrave", projekt i cili u zhvillua nga Bashkia Himarë.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të Vendimit të KKTKM-së nr. 466, datë 16.09.2022.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Klesta QIRICI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 113 Prot.

Tiranë, më datë 16.09.2022

VENDIM

Nr. 466, datë 16.09.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.09.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Sistemi i Furnizimit me Ujë të Himarës, Lidhja e Linjës Kryesore të Dërgimit me sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave Pëllur, Kudhës, Himarë Fshat dhe Vuno si dhe Rrjeti i brendshëm i Ujësjetës të këtyre fshatrave", me aplikues Genti Çupi dhe zhvillues Bashkia Himarë, Miratuar në Parim me Vendim KKTKM nr. 451, datë 31.08.2022;
 2. Zhvilluesi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas aplikuesi mund të vijoje me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Punimet në Qendrën Historike të Himarës, pranë Shpellës së Spillesë, si dhe pranë depos aktuale të ITUN Himarë, duhet të shoqërohen me një program monitorimi arkeologjik dhe dokumentimi stratigrafik nga subjekt i licencuar në arkeologji. Raportet e monitorimit arkeologjik dhe dokumentimit të depozitohen pranë IKTK;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", nenet 145- 147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 5. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

